

## **NDRYSHIMET NË MATURËN SHETËRORE 2011**

**Në fund të studimeve të shkollës së mesme nxënësit nuk do të marrin deftesë pjekurie ,por do të marrin Diplomën e Maturës,e cila është më e vlefshme dhe me një fushë njohje më të gjerë se e para.**



**Por ,që një maturant ta fitoj këtë Diplomë duhet tu nënshtrohet katër provimeve të Maturës Shtetërore,dy provimeve të detyruara dhe dy provimeve me zgjedhje ,e jo më vetëm dy provimeve të deturuara.**



**Në ndryshim nga vitet e kaluara provimet e Maturës Shtetërore do të zhvillohen vetëm një here në vit, pra nuk do të ketë më një sezon të dytë ,sezon vjeshte.**



### *Të dashur maturantë,*

Çdo ditë që kalon, gjithnjë e më shumë, na ndërgjegjëson se e ardhmja e botës globale është dija dhe qytetërimi.

Reformat e thella e të vazhdueshme, që janë marrë dhe vazhdojnë të ndërmerren në sistemin arsimor, po na bindin për vizione, alternativa, ridimensionime e përmirësime të vazhdueshme me synimin e vetëm ***gjithçka për ju, për të ardhmen tuaj, për ëndrrat tuaja.***

Modernizimi i sistemit, rritja e cilësisë së shërbimit arsimor dhe përbushja e standardeve arsimore evropiane janë dimensionet tona drejt familjes evropiane.

Një proces kurorëzues i gjithë kësaj pune është **Matura Shtetërore.**

Rezultatet e arritura në krijimin e një sistemi bashkëkohor dhe evropian, vlerësimi dhe pranimi në institucionet e arsimit të lartë, në forcimin e garancisë, integritetit, transparencës dhe besimit në këtë shërbim arsimor, na ftojnë që të kërkojmë dhe të realizojmë standarde të reja edhe më cilësore.

Duke marrë parasysh kërkesat e reja, zërin tuaj, të prindërve, mësuesve dhe të gjithë shoqërisë, në këtë vit shkollor Matura Shtetërore, Matura Juaj, do të sjellë risi, të cilat duhet të njihen dhe zbatohen me korrektësi nga çdo maturant gjatë gjithë procesit.

Objektiv, për secilin nga ju, është përfundimi me sukses i shkollës së mesme dhe diplomimi, si kusht për të fituar të drejtën e vazhdimit të studimeve në institucionet e arsimit të lartë publik e privat.

Një maturant, që të fitojë diplomën e Maturës, duhet t'u nënshtrohet katër provimeve të Maturës Shtetërore (standard i njësuar dhe i përgjithshëm, provimeve të detyruara dhe me zgjedhje).

Provimet e Maturës përbëhen nga provime të detyruara dhe provime me zgjedhje.

1. Provimet e Maturës zhvillohen vetëm një herë në vit.
2. Provimet e Maturës zhvillohen vetëm me shkrim.
3. Provimet e detyruara zhvillohen në ditë të ndryshme.
4. Provimet me zgjedhje zhvillohen në një ditë.



**Pë ata maturantë që do të jenë mbetës në klasë me 1 ose 2 lëndë,do ti japin ato në sezonin e dytë ( vjeshtë )dhe nëse i marrin ,do tu jepet e drejta ti japin provimet e Maturës Shtetërore në vitin shkollor pasardhës,kështu formulari A1 plotësuar prej tyre është i pavlefshëm dhe vitin e ardhshëm ,në Mars ata do të plotësojnë një A1 tjetër.**




**Nëse një maturant përjashtohet nga një provim për kopjim,ai e humbet të drejtën për të marrë pjesë në provimet pasardhëse të këtij viti, pra do ti japi ato një vit më vonë.**



**Shpallja e rezultateve nuk do të bëhet më pas 15 ditësh ,por pas 10 ditësh pas çdo provimi të Maturës Shtetërore.**



**Në ndryshim nga vitet e kaluara të MSH sivjet në Rregullore është e përcaktuar qartë se çfarë i lejohet të ketë maturanti ditën e provimit: vetëm stilolaps blu ose të zi dhe në provimin e matematikës ,vizore e kompas.**



Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës i jep çdo nxënës që ka përfunduar vitin e fundit të shkollës së mesme dhe ka plotësuar formularin përkatës.

Hapi i parë dhe kusht i domosdoshëm në kryerjen e Maturës Shtetërore është regjistrimi i çdo maturanti për të dhënë katër provimet.

Regjistrimi realizohet në muajin mars me plotësimin e formularit A1 dhe A1Z nga të gjithë ju, pavarësisht nga rezultatet e semestrit të parë dhe atyre në vazhdim, deri në momentin e plotësimit të formularit.

Çdo maturant plotëson dhe dorëzon Formularin A1 dhe A1Z në Komisionin Shkollor të Maturës Shtetërore, ku do të japë provimet, brenda datës 10 Mars. Formulari A1 përmban të dhënat e maturantëve/kandidatëve dhe të shtetasve shqiptarë që kanë përfunduar shkollën e mesme këtë vit shkollor, ndërsa formulari A1Z përmban të dhënat e maturantëve/kandidatëve dhe të shtetasve

shqiptarë që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2010 ose jashtë vendit. Është e domosdoshme që të njiheni me indeksin e llojit të shkollës dhe me koeficientet e programeve të studimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik (IALP) të miratuara për këtë vit.

Në shkolla organizohet procesi i këshillimit të maturantëve për plotësimin e Formularëve.

Në muajin shkurt, afat i përcaktuar në Rregulloren e Maturës Shtetërore të këtij viti, ju do të keni në dorë:

- a. Tabelën e indeksit të llojit/profilin të shkollave të mesme,
- b. Koeficientet e lëndëve me zgjedhje të propozuara nga IALP,
- c. Udhëzuesin e plotësimit të formularit A1, A1Z,

### KUJDES!

Në listat që Agjencia e Vlerësimit të Arritjeve të nxënësve (AVA) dërgon në shkolla dhe që afishohen në këndin e Maturës Shtetërore, për çdo maturant ka një numër identifikimi ID dhe të gjithë të dhënat e tjera personale sipas formularit A1. Regjistroni dhe mbani mend numrin tuaj të identifikimit (ID) dhe kontrolloni saktësinë e të dhënave që paraqiten në listën e AVA. Nëse aty gjeni pasaktësi, paraqitini ato në Komisionin Shkollor të Maturës Shtetërore për t'i dërguar në AVA. Ruani kurdoherë një kopje të formularëve e të çdo dokumenti tjetër deri në fund të procesit të Maturës Shtetërore.

Një ditë pas përfundimit të vitit shkollor Komisioni Shkollor i Maturës Shtetërore (KSHMSH) shpall listën e maturantëve që do të japin provime të detyruara dhe me zgjedhje si

## ÇFARË PRESIM PËR ECURINË E PROÇESIT

Jemi në pritje të ardhjes të Rregullores së Maturës Shtetërore 2011,ku më pas do të filloj puna me intensitet të lartë për këtë process të rëndësishëm.

Në shkurt ,afat i përcaktuar ky në Rregulloren e Maturës 2011 do të kemi në dorë dhe :

 Tabelën e indeksit të llojit/profilit të shkollave të mesme

 Koefiçientët e lëndëve me zgjedhje të propozuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë Publik ( IALP )

 Udhëzimin e plotësimit të formularit A<sub>1</sub> e A<sub>1</sub>-Z

 Brënda datës 10 Mars 2011 do të dorëzohen nga maturantët Formularët A<sub>1</sub> e A<sub>1</sub>-Z ne Komisionet Shkollore të MSH.



Qysh në muajin mars, për t'ju dhënë mundësinë e përgatitjes në kohë, ju do të keni në dorë Programet orientuese lëndore, shpjeguesin e tyre dhe bankën e pyetjeve për provimet e detyruara dhe ato me zgjedhje. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës i jep çdo nxënës që ka përfunduar vitin e fundit të shkollës së mesme dhe ka plotësuar formularët përkatës.

Të gjithë maturantët u nënshtrohen provimeve të detyruara dhe me zgjedhje sipas Rregullores së përcaktuar. Që ju të arrini suksesin e dëshiruar, veç përgatitjes në provime duhet të respektoni të drejtat dhe detyrat tuaja në procesin e dhënies së provimeve.

dhe listën e mjediseve ku do të zhvillohen provimet. Maturantët mbetës, qoftë dhe në një lëndë në klasën e fundit të gjimnazit apo çdo shkolle tjetër të mesme 4 e 3+2 vjeçare, e humbasin të drejtën për të hyrë në provimet e Maturës Shtetërore.

Provimet e lëndës/ve të klasës (1-2) jepen në sesionin e vjeshtës. Nëse ato fitohen maturantit/kandidatit i jepet e drejta për t'i dhënë provimet e Maturës vetëm në vitin shkollor pasardhës. Në këtë rast Formulari A1 i plotësuar është i pavlefshëm për vitin e ardhshëm. Në sesionin e vitit pasardhës maturant/kandidati do të plotësojë një tjetër formular A1 për të fituar të drejtën e regjistrimit në Maturën Shtetërore.

Çdo maturant, që ka fituar të drejtën të hyjë në provimet e Maturës, duhet të informohet saktë për mjedisin ku do të zhvillojë provimet.

### KUJDESI!

*Në ditën e provimit:*

Maturanti/kandidati paraqitet në mjedisin e provimit një orë përpara fillimit të provimit. Në këtë kohë kryhet identifikimi i maturantit/kandidatit, hyrja në mjediset e provimit (klasa), sistemimi i tyre nëpër vende si dhe leximi i rregullave për maturantët/kandidatët.

Nëse testi që i jepet maturantit është i dëmtuar ose ka faqe të bardha, ai ka të drejtë të kërkojë menjëherë ndërrimin e testit.

Maturanti/kandidati duhet të përdorë: stilolaps me një ngjyrë (të zezë ose blu) dhe vizore e kompas vetëm për provimin e matematikës.

Maturantët/kandidatët që dorëzojnë testin e provimit përpara kohës së përcaktuar, nuk duhet të dalin nga

**Në muajin Mars do të kemi në dorë:**

-  **Programet orientuese lëndore**
-  **Shpjeguesin e programeve**
-  **Bankën e pyetjeve për provimet me zgjedhje dhe ato të detyruara.**

 **Brënda datës 30 korrik maturantët plotësojnë dhe dorëzojnë tek Komisioni i Maturës Shtetërore në shkollë Formularin A2.**



mjedisi më herët se sa 30 minuta para orarit të përfundimit të provimit. Ata grumbullohen në një sallë brenda mjedisit të provimit të përcaktuar që më parë.

Në rast se maturanti/kandidati vëren ndonjë shkelje të rregullores së provimit, ka të drejtë të informojë për parregullsinë e konstatuar tek Administratori i Provimit (AP), Përgjegjësi i Administrimit të Provimit (PAP) dhe përfaqësuesi i DAR/ZA-së.

Maturanti/kandidati ka të drejtë të kërkojë fotokopjen e testit të tij pas përfundimit të të gjitha provimeve me një kërkesë drejtuar Komisionit të Maturës Shtetërore (KMSH) së DAR/ZA-së.

### **KUJDES!**

***Ju nuk mund të hyni në provim, nëse:***

- Nuk jeni në listat e AVA-s,
- Nuk jeni të pajisur me dokument identifikimi,
- Keni telefon celular, radio ose çdo mjet tjetër komunikimi.

***Ju përjashtoheni nga provimi dhe nuk u njihet rezultati, nëse:***

- Nuk qëndroni në vendin që ju është caktuar;
- Merrni informacion nga të tjerët,
- U jepni informacion të tjerëve,
- Merrni kopje,
- Jepni kopje,
- Komunikoni me maturantë të tjerë,
- Bëni komente për përmbajtjen ose zgjidhjen e testit gjatë kohës së zhvillimit të provimit,
- Mbanë telefon celular, radio ose çdo mjet tjetër komunikimi në mjedisin e provimeve,

### **KUJDES!**

Nëse përjashtoheni nga provimi për kopjim (merrni a jepni kopje), humbisni këtë provim dhe të drejtën për të marrë pjesë në provimet pasardhëse për sesionin e këtij viti. Këtë/0 provime mund t'i jepni vetëm vitin e ardhshëm shkollor.

**Mosnjohja e rezultatit të provimit mund të ndodhë edhe gjatë procesit të vlerësimit të testeve, në rast se ju:**

- Përdorni laps ose stilolapsa me ngjyra të ndryshme në plotësimin e testit.
- Nuk është kryer procesi i sekretimit dhe testi juaj është pa barkod.
- Hiqni, shkruani ose dëmtoni kodin e sekretimit (barkodin) të vendosur në test.
- Dëmtoni testin (palosni, zhubrosni, grisni, vendosni shenja të dallueshme dhe të veçanta).
- Vërtetohet kopja, qoftë dhe e pjesshme, me një test tjetër, mbas shqyrtimit në KOPOTED. Në këtë rast, të dy a më shumë testet konsiderohen të pavlefshëm dhe nuk njihet rezultati.

Për të rritur saktësinë e vlerësimit të testeve tuaja janë marrë masa që ato të vlerësohen me plikë dhe ekuivalentohen në notë të përshkallëzuar. Testet e provimit të Maturës vlerësohen nga ekspertët më të mirë të lëndës.

Çdo përgjigje e testit i nënshtrohet një vlerësimi të dyfishtë, të pavarur nga njëri-tjetri. Testet kodifikohen.

Shpallja e rezultateve do të bëhet, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë, pas çdo provimi të Maturës.

Çdo maturant që kalon katër provimet (e detyruara dhe me zgjedhje) pajiset me Diplomën e Maturës.

Me të dalë rezultatet e katër provimeve të Maturës, ju, në bazë të informacioneve që ju janë vënë në dispozicion, duhet të merrni vendimet më të mira për të ardhmen

tuaj. Këto vendime ju do t'i pasqyrojnë me plotësimin e Formularit A2.

Maturantët që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në IALP, pasi janë njohur me të gjitha rezultatet e provimeve të Maturës, plotësojnë formularin A2 dhe e dorëzojnë atë në shkollë te Komisioni Shkollor i Maturës Shtetërore (KSHMSH) brenda datës 30 korrik.

Formulari A2 është i personalizuar me notën mesatare dhe preferencën e programeve të studimit të shpallura nga IALP.

### KUJDES!

Zbatoni me rigorozitet Udhëzuesin e plotësimin të formularit A2.

Formularin A2 e plotësojnë vetëm maturantët kalues në të gjitha provimet e detyruara dhe me zgjedhje. Pas plotësimin, çdo formulari i bëhet një fotokopje, e cila ruhet në drejtorinë e shkollës deri në përfundim të procesit të Maturës. Është mirë që edhe ju të mbani një kopje të tij deri në fund të procesit për çdo ballafaqim të mundshëm. Maturanti që mbetet në një a më shumë provime të Maturës, nuk pajiset me diplomën e Maturës. Çdo maturant mbetet, (me notë të shkallëzuar më të ulët se 4.51 ose të rrumbullakosur 5), qoftë dhe në një nga provimet e detyruara (D1, D2) apo me zgjedhje (Z1, Z2) ka të drejtën e riprovimit të lëndës/ve në vitet e ardhshme shkollore dhe, vetëm pasi të jetë vlerësuar kalues në të katër provimet, pajiset me diplomë dhe mund të konkurrojë për programet e studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik.

# Sukcesere



Republika e Shqipërisë



Ministria e Arsimit  
dhe Shkencës,  
Tel: 3554222260  
Fax: 3554222260  
[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)